

PROCESVERBAL
nga vazhdimi i parë i seancës së 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 18.2.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Afrona Vërzivolli (pushim vjetor), Petar Xhurovski (pushim mjekësor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, mr. Argjend Xhelili, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pransihmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit mr. Sasho Stefanovski hapi vazhdimin e parë të seancës së 6-të. Seanca filloi në ora 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Kryetari Stefanovski njoftoi se seanca do të shqyrtohet Pika 4 e Rendit të ditës nga seanca e 6-të, me titull: „Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: qiramarrje të automjeteve (lizing operativ)“, e cila u anulua.

Pika 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se në seancën paraprake për këtë pikë është dhënë shpjegim dhe është zhvilluar një diskutim me anëtarët e Këshillit, pas së cilës është pranuar propozimi që shqyrtimi të anulohet. Ai gjithashtu deklaroi se, në pajtim me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2026 dhe Planin për furnizim publik për vitin 2026, të miratuar në dhjetor të vitit të kaluar, ku është parashikuar të merren me qira tre automjete. Megjithatë, duke pasur parasysh se ende nuk është zgjedhur zëvendësi i drejtorit, propozohet në vendë të treautomjeteve të merren dy. Mjetet për këtë furnizim sigurohen nga buxheti për vitin 2026, dhe do të planifikohen dhe mjete për dy vitet e ardhshme, përkatësisht për vitin 2027 dhe 2028.

Këshilli i Agjencisë me 4 vota „pro“ dhe një votë „kundër“ nga këshilltarja Gordana Majnova, i dha miratim drejtorit të Agjencisë, për zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: qiramarrje të automjeteve (lizingu operativ).

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-mallra: qiramarrje të automjeteve (lizing operativ), është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.05-5639/1 datë 26.12.2025, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, përkatësisht do të sigurohen shtesë nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2027 dhe 2028.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani